



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government

Ministria e Drejtësisë/MinistarsvoPravde/Ministry of Justice

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm - Kancelaria Generalnog Sekretara - Office of the Secretary General

Nr. 50/2026
Datë: 04/05/2026

Në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, duke u bazuar në nenin 65 (paragrafi 1, 2, 3 dhe 4) të Ligjit Nr. 08/L -197 për Zyrtarët Publik i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 08/L-294, si dhe në përputhje me nenin 11 (paragrafi 4) të Rregullores Nr.02/2024 për Transferimin e Nëpunësve Civilë, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Drejtësisë nxjerr këtë:

V E N D I M

për transferimin e përhershëm të nëpunësit civil për interes të institucionit

1. Znj. Medina Sopjani, nga pozita aktuale Zyrtare për Integrim Evropian dhe Koordinim të Donatorëve në Divizionin për Integrim Evropian dhe Koordinim të Donatorëve në Departamentin për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave, transferohet përhershëm brenda të njëjtës kategori të shërbimit civil për interes të institucionit në pozitën: Zyrtare e Lartë për Koordinim të Politikave në Divizionin për Koordinim të Politikave në Departamentin për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave.
2. Obligohet Divizioni për Burime Njerëzore dhe Departamenti për Buxhet dhe Financa që të ndërmarr të gjitha veprimet për zbatimin e këtij vendimi dhe pagesën e nëpunësit sipas pagës së pozitës në të cilin është transferuar.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit

A r s y e t i m

Në zbatim të Rregullores ZKM - Nr. 10/2023 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Drejtësisë, dhe për shkak të nevojës për plotësimin e pozitës si dhe në interes të institucionit, më datë 22.04.2026 është paraqitur kërkesa për transferim të përhershëm të nëpunëses civile znj. Medina Sopjani. Transferimi bëhet brenda të njëjtës kategori profesionale, nga pozita Zyrtare për Integrim Evropian dhe Koordinim të Donatorëve në Divizionin për Integrim Evropian dhe Koordinim të Donatorëve në kuadër Departamentin për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave në pozitën Zyrtare e Lartë për Koordinim të Politikave në Divizionin për Koordinim të Politikave, në kuadër të Departamentit për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave.

Andaj, në mbështetje të nenit 65 (paragrafi 1,2,3 dhe 4) të Ligjit nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik dhe nenit 11 (paragrafi 4) të Rregullores Nr.02/2024 për Transferimin e Nëpunësve Civilë, duke u bazuar në kërkesën e arsyetuar për këtë transferim, dhe pas marrjes së pëlqimit nga nëpunësja civile, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Ridvan Hoti

Sekretar i Përgjithshëm



Vendimi u dërgohet:

- Znj.Medina Sopjani;
- Kabinetit të Zëvendëskryeminstres dhe Ministres së Drejtësisë në detyrë;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Departamentit për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave;
- Departamentit për Buxhet dhe Financa;
- Divizionit për Burime Njerëzore;
- Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë.